

LIGJ
Nr. 8570, datë 20.1.2000

PËR DISA NDRYSHIME NË KODIN E PROCEDURËS PENALE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 81 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Neni 263 ndryshohet si vijon:

“Afatet e kohëzgjatjes së paraburgimit

1. Paraburgimi e humbet fuqinë në qoftë se nga fillimi i zbatimit të tij kanë kaluar afatet e mëposhtme, pa u dorëzuar aktet në gjykatë:

- a) tre muaj, kur procedohet për kundërvajtje penale;
- b) gjashtë muaj, kur procedohet për krime që dënohen në maksimum deri në dhjetë vjet burgim;
- c) dymbëdhjetë muaj, kur procedohet për krime që dënohen në minimum jo më pak se dhjetë vjet burgim ose me burgim të përjetshëm.

2. Paraburgimi e humbet fuqinë në qoftë se nga dita e dorëzimit të akteve në gjykatë kanë kaluar afatet e mëposhtme, pa u dhënë vendimi i dënimit në shkallë të parë:

- a) dy muaj, kur procedohet për kundërvajtje penale;
- b) nëntë muaj, kur procedohet për krime që dënohen në maksimum deri në dhjetë vjet burgim;
- c) dymbëdhjetë muaj, kur procedohet për krime që dënohen në minimum jo më pak se dhjetë vjet burgim ose me burgim të përjetshëm.

3. Paraburgimi e humbet fuqinë në qoftë se nga dita e dhënies së vendimit të dënimit në shkallë të parë kanë kaluar afatet e mëposhtme pa u dhënë vendimi i dënimit në gjykatën e apelit:

- a) dy muaj, kur procedohet për kundërvajtje penale;
- b) gjashtë muaj, kur procedohet për krime që dënohen në maksimum deri në dhjetë vjet burgim;
- c) nëntë muaj, kur procedohet për krime që dënohen në minimum jo më pak se dhjetë vjet burgim ose me burgim të përjetshëm.

4. Në rastet kur vendimi priset nga Gjykata e Lartë dhe çështja i dërgohet gjykatës së shkallës së parë ose apelit, si dhe kur vendimi priset nga gjykata e apelit dhe i dërgohet gjykatës së shkallës së parë, nga dita e dhënies së vendimit të Gjykatës së Lartë apo të apelit, fillojnë përsëri afatet e parashikuara, për secilën shkallë të procedimit.

5. Në rast ikje të të pandehurit të paraburgosur, afatet fillojnë të ecin përsëri nga çasti në të cilin ai paraburgoset përsëri.

6. Kohëzgjatja tërësore e paraburgimit, duke marrë parasysh edhe zgjatjen e parashikuar nga neni 264 pika 2, nuk mund të kalojë këto afate:

- a) dhjetë muaj, kur procedohet për kundërvajtje penale;
- b) dy vjet, kur procedohet për krime që dënohen në maksimum deri në dhjetë vjet burgim;
- c) tre vjet, kur procedohet për krime që dënohen në minimum jo më pak se dhjetë vjet burgim ose me burgim të përjetshëm.”

Neni 2

Në nenin 264 pika 2, fjalia e fundit ndryshohet si vijon:

“Zgjatja mund të bëhet vetëm një herë dhe nuk mund të jetë më shumë se tre muaj.”

Neni 3

Neni 265 ndryshohet si vijon:

“Pezullimi i afateve të paraburgimit

1. Afatet e parashikuara nga neni 263 pezullohen me vendim të ankimueshëm të gjykatës:

a) për kohën që shqyrtimi gjyqësor është pezulluar ose shtyrë për shkak të veprimeve apo kërkesave të padrejta të bëra nga i pandehuri ose mbrojtësi i tij, përveç rasteve kur kërkesa bëhet për marrjen e provës;

b) për kohën që shqyrtimi gjyqësor është pezulluar ose shtyrë për shkak të mosparaqitjes ose të largimit të një a më shumë mbrojtësve, që lënë pa ndihmë një a më shumë të pandehur.”

Neni 4

Dispozitë kalimtare

Afatet e kohëzgjatjes së paraburgimit, sipas këtij ligji, do të zbatohen ndaj personave që paraburgosen pas hyrjes në fuqi të tij.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2537, datë 30.1.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani